

VENDIM
Nr. 388, datë 6.5.2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 118, DATË 5.3.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PROCEDURAT E EMËRIMIT, REKRUTIMIT, MENAXHIMIT DHE PËRFUNDIMIT TË MARRËDHËNIES NË SHËRBIMIN CIVIL TË NËPUNËSVE CIVILË TË NIVELIT TË LARTË DREJTUES DHE TË ANËTARËVE TË TND-së"

Në mbështetje të pikës 5, të nenit 100, të Kushtetutës dhe të neneve 28, pika 6, 29, pika 5, 30, pika 6, 31, pika 3, e 32, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 118, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2, e kreut II, ndryshohet si më poshtë vijon:
"2. Përfaqësuesi i DAP-it është, për shkak të detyrës, drejtori i DAP-it, i cili kryeson komisionin. Përfaqësuesi i ASPA-s është, për shkak të detyrës, drejtori i ASPA-s."
2. Në pikën 3, të kreut II, fjalët "... dy përfaqësuesit ..." zëvendësohen me fjalët "... një përfaqësues ...".
3. Shkronja "e", e pikës 5, të kreut II, shfuqizohet.
4. Në pikën 6, të kreut II, fjala "... kandidatët ..." zëvendësohet me fjalën "... kandidatin ...".
5. Në shkronjën "a", të pikës 1, të kreut IV, pas fjalëve "... kategorisë së mesme drejtuese ..." shtohen fjalët "... dhe të nivelit të lartë drejtues, në institucionet e pavarura ...".
6. Në pikën 7, të kreut VII, pas fjalëve "... të nivelit të mesëm drejtues..." shtohen fjalët "... në një institucion të administratës shtetërore ...".
7. Paragrafi i parë, i pikës 14, të kreut VII, ndryshohet, si më poshtë vijon:
"14. Një anëtar i TND-së, i caktuar si koordinator i posaçëm apo në një pozicion të kategorisë së mesme drejtuese:"
8. Në pikën 15, të kreut VII, fjalët "... në pikën 13 ..." zëvendësohen me fjalët "... në pikën 14 ...".
9. Pika 16, e kreut VII, shfuqizohet.
10. Pas pikës 17, të kreut VII, shtohen pikat 18, 19, 20 e 21, me përmbajtjen si më poshtë vijon:
"18. Në rast se prurjet nga ASPA dhe nga procedurat e pranimit të drejtpërdrejtë nuk janë të mjaftueshme, nëpunësit e kategorisë së lartë drejtuese të institucioneve të pavarura, që kanë interes, mund të paraqesin kërkesë për t'u pranuar, drejtpërdrejt, në TND.
19. Departamenti i Administratës Publike analizon nëse nëpunësi i plotëson kërkesat e përgjithshme, kuadrin e kompetencës dhe kërkesat e posaçme, bazuar në të dhënat e shpallura në procedurën e fundit konkurruese, që është zhvilluar për këtë qëllim, brenda 30 ditëve.
20. Në rast se nëpunësi që ka bërë kërkesën i plotëson kriteret, Departamenti i Administratës Publike komunikon me njësinë përgjegjëse të institucionit të pavarur dhe, në rast të dhënies së mendimit pozitiv, nga ana e tyre, brenda 5 ditëve emëron nëpunësin në një pozicion TND-je në institucionin e administratës shtetërore.
21. Nëpunësi, që është emëruar sipas pikës 20, të kreut VII, të këtij vendimi, është i detyruar të ndjekë programin e formimit të thelluar për anëtarët e TND-së, të organizuar nga ASPA."
11. Pika 1, e kreut VIII, ndryshohet si më poshtë vijon:
"1. Pranimi në kategorinë e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues, në institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore, bëhet me konkurrim, të organizuar për një apo më shumë pozicione pune të lira, dhe është i hapur për:
a) nëpunësit civilë të kategorisë së mesme drejtuese të shërbimit civil;

b) kandidatë të tjerë, jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat specifike për pranimin në këtë kategori, por, në asnjë rast, më shumë se 15% (pesëmbëdhjetë për qind) të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kategorisë së lartë drejtuese, për atë institucion. Të drejtën për të vendosur që kjo procedurë të jetë e hapur edhe për këta kandidatë e ka titullari/organi vendimmarrës i institucionit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama